STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 15 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIHAPJEN E TUNELIT KUINS MIDTAUN (QUEENS MIDTOWN) PER TRAFIKUN E KAMIONAVE

Ndalimi i kamionave hiqet duke filluar në 6 të mëngjesit, të premten, 16 nëntor

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Tuneli Kuins Midtaun (Queens Midtown) do të rihapet për kamionat të premten në mëngjes, duke kthyer trafikun e plotë në tunel pasi të dyja pjesët u përmbytën gjatë Uraganit Sendi (Sandy).

Rihapja shënon një arritje tjetër në rimëkëmbjen e shpejtë të lidhjes së rëndësishme të Autoritetit të Transportit Metropolitan (MTA) ndërmjet Kuins (Queens) dhe Manhatan (Manhattan). Tuneli u rihap për autobusat në 6 nëntor, për makinat në 9 nëntor dhe tani për kamionat duke filluar në 6 të mëngjesit, të premten, 16 nëntor.

"Përparimi që u bë në rikthimin e Tunelit Kuins Midtaun (Queens Midtown) është pak a shumë i mrekullueshëm," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Tuneli nuk ishte përmbytur kurrë në historinë 72-vjeçare të tij, por pasi ishte nën ujë, është rikthyer në shërbim si një lidhje jetësore rajonale, si për udhëtarët, ashtu edhe për tregtinë."

Personeli i Tunelit Kuins Midtaun (Queens Midtown) kaloi pesë ditë duke hequr ujin nga dy pjesët 1.6 milje të gjata. Puna pastaj kaloi tek dhoma e pompës në mes të lumit, për t'u përqëndruar në rikthimin e pompave në gjendje pune.

Riparime të mëdha elektrike gjithashtu u desh të bëhen gjetkë, përfshirë në sistemin e ndriçimit të tunelit, dritat e trafikut, sistemin e zbulimit të automjetit mbi gjatësi dhe kutive elektrike brenda tunelit, të cilat ishin zhytur krejtësisht në ujë.

"Punonjësit dhe kontraktorët e Urave dhe Tuneleve të MTA-së punuan pa lodhje pa pushim për të rikthyer shërbimin, sepse e kuptojnë rëndësinë e këtij tuneli, jo vetëm për Qytetin e Nju Jorkut, por për të gjithë rajonin," tha Kryetari dhe CEO i MTA-së Jozef J. Lota (Joseph J. Lhota). "Rifillimi i trafikut të kamionave përmes kësaj lidhje jetësore është një hap tjetër përpara drejt rimëkëmbjes së rajonit."

Tuneli i Kuins Midtaun (Queens Midtown), që u hap për trafikun në 15 nëntor 1940, transporton 78,000 automjete mesatarisht çdo ditë të javës.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418